



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA KRUIJË  
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Kruje me \_\_\_\_ .03.2023

**PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME**  
**ME**  
**OBJEKT**

- **LOTI I I: (STUDIM PROJEKTIM PER OBJEKTIN, ”NDËRTIM QENDRE REKREATIVE DHE RIKUALIFIKIM URBAN I PARKUT TË REZERVUARIT THUMANË, KRUIJË”**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me date 27.03.2023 ne Kruje prane Zyres se Prokurimeve , nga ana e Pergjegjesit te Njesise se Prokurimit i caktuar me urdherin nr.01 datë, 04.01.2023, te Titullarit te AK , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit e llojit “E Hapur e Thjeshtuar” dhe ne referim te urdherit te **prokurimit nr.202, date 27.03.2023** , me te dhenat si vijon:

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Loti i I: (Studim Projektim per objektin, ”Ndërtim Qendre Rekreative dhe Rikualifikim Urban i Parkut të Rezervuarit Thumanë, Krujë”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Konsulence per ndertimin /(71315200-1 )

**VLERA E FONDIT LIMIT LOTI I : 4’017’616(katermilion e shtatembedhjete mije e gjashteqind e gjashtembedhjete ) lekë pa TVSH.**

**BURIMI I FINANCIMIT** :Te ardhurat e Bashkise Kruje

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### ▪ **LOTI I I: (STUDIM PROJEKTIM PER OBJEKTIN, "NDËRTIM QENDRE REKREATIVE DHE RIKUALIFIKIM URBAN I PARKUT TË REZERVUARIT THUMANË, KRUIJË"**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5; (Ne vleren prej 2 % te fondit limit te lotit nr .1 )*

**1-a)** Operatori ekonomik nuk duhet te kete detyrime te taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe ato te vitit 2022 te njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2022 per secilin operator)*

**Shenim-**Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.12, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2022 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2022 per secilin operator).*

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 41, pika 5 nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 "Per QKB" i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR" i ndryshuar.

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12 ).

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

b)Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë të vlefshme profesionale të shoqërisë dhe të drejtuesve teknikë, për studim e projektim, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore (sipas modelit të miratuar nga MZHU/MTI/MIE) me kategoritë e mëposhtme:

**Kat 2.d /**(Projektim arkitekturor peisazhi sistemim sipërfaqe të gjelbera ,lulishte e parqe)

**Kat 6.a/**(Projektues Rruge e hekurudha ,rruge locale,rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore)

**Kat 3.b.2 /**(Projektues Konstruktivor –Objekte me skelet metalik)

**Kat 8.a/**(Projektues Gjeodet-Rivelime inxhinierike)

**Kat 3.d/**(Projektues Konstruktivor-Vleresimi i kapacitetit mbajtës dhe perforcimi i strukturave prej beton-arme, murature dhe metalike)

**Kat 4.i/**(Projektues Instalator/Projektim i ndricimit rrugor ,shesheve dekorativ,ndricimit të objekteve të mëdha sportive ,porteve aeroportive etj)

**Kat 5.d/**(Projektues Vepra Hidraulike-Vepra ujitje kullimi impiante vaditese diga të vogla(ato që nuk plotesojnë kushtin e digave të mëdha), damba, sifona , kaskada, kapërdredhese ,rrymeshpejtuese, prize,baraze, porta , tombina)

**Kat 9.e/**(Studim Gjeologjik Inxhinierik Hidrogjeologjik-Studime Projektive Hidrogeologjike).

**Shënim** –Licenca duhet të jetë lëshuar sipas rregullave të VKM nr 759 date 12.11.2014 ‘‘Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’’ i ndryshuar me VKM nr 943 date 28.12.2016.

- *Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licencat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Kategoritë e kerkuara janë kërkuar

bazuar në elementet perkates te Detyres se Projektimit (Termave te References per Sherbimin e Projektimit ).

*Kerkesa e disponimit te nje license te tille te leshuar nga ana e organeve kompetente eshte e lidhur ngushtesisht me tipologjin e sherbimit te kerkuar objekt kontrate te Detyres se Projektimit (Termave te References per Sherbimin e Projektimit ).Ne permbajte te Termave te references per lotin perkates, jane te detajuara edhe arsyet konkrete te perzgjedhjes te kategorise perkatese te licenses profesionale ne projektim. Licensat e mesipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.(me konkretizimin e preventivit te zbatimit ).*

**2.1.c)Operatori ekonomik duhet të vërtetoje që ka të punësuar me kontratë 1(nje) ekspert mjedisor i cili duhet të jetë i regjistruar dhe i siguruar(te kete te punesuar me kontrate Ekspert te certifikuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave për vleresim të ndikimit në mjedis dhe auditim Mjedisor).**

- **Shenim-**Per te provuar kriterin e mesipërmpersa i perket ekspertit mjedisor te paraqitet kontrata e punes e vlefshme, Diploma, Libreza e punes si dhe certifikata perkatese e vlefshme e leshuar nga insitucionet kompetente.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te references, natyres se pergjithshme te sherbimeve qe priten te ofrohen.

**Me konkretisht 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, gjykohet si i domosdoshem per realizimin e VNM (Vleresimet e ndikimit ne Mjedis) per projektet qe do te realizohen.**

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.a-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2020’2021’2022),ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te kontrates/ **lotit nr.1(për secilin prej loteve/ shumatores së loteve për të cilat konkurron”)**.**

**Shenim-**Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore .

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është "Sherbim Konsulencë", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: "40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit..... dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim Konsulencë" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77 të LPP, si edhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pika 5 dhe 6, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në vlerën e marre reference për kufirin e raportit të % së kufirit të xhiros për të konsideruar të plotësuar kriterin e mesiperm, argumentojmë se ky raport që përben kufirin maksimal të përcaktuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i atribuohet faktit se duke marrë në analizë vlerën e fondit limit është me se e mundur që ky kufi iu jep mundësi të gjithë subjekteve ekonomike të cdo lloji kapaciteti financiar (te mesem dhe te vegjel), të kenë mundësinë e ofertimit pasi është marzhi tejet i aksesueshem

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës **me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës/lotit (për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron)**, që prokurohet .

## **Për të vërtetuar këtë Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin:**

- Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme, është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kontratës si dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruara nga të dyja palët.
- Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

***Shenim:** Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 54, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës** së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

---

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

### **3.4. Personeli dhe fuqia punetore:**

Kandidati/ofertues duhet të vërtetojë se disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës dhe për këtë provuar këtë kusht duhet të ketë **një punësim mesatar për**



**periudhen , Dhjetor 2022 , deri ne Shkurt 2023 i te pakten 7 (shtate) personave duke përfshirë stafin e përhershëm te provuar si me poshte :**

- Kjo pike (2.3.4 ), provohet duket paraqitur nga ana e OE , vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates

**ose**

- Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 025) sipas formatit elektronik ne perputhje me VKM nr 922 date 29.12.2014''**Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike''**

**Shenim-** Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.12 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: per percaktimin e fuqise punëtore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas detyres se projektimit. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri I mesiper perkon me stafin qe pritet te jete I angazhuar ne keto procedura.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument qe vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

### **2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**3.6-a)**Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre ekonomike/financiare duhet ti referohen VKM nr.354,datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim", si dhe Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, me Nr. 5585 Prot "Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354,datë

11.05.2016” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” si dhe Rekomandimit të datës 27.06.2018 me nr 6559 prot te APP.

**b)Shenim-**Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vleres minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” .

**Argumentimi:** : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në njoftimin Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.Duke qene se **per perlllogaritjen e vleres limit te kontrates,AK eshte mbeshtetur ne Ligjin Nr.162 date 23.12.2020** “Për Prokurimin Publik”,Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016, dhe nenit 76 të VKM, Nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sipas të cilit:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose me shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

**3.5-.Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesi Certifikatat e Standartizimit si vijon të vlefshme :**

- **ISO 9001:2015** (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) E vlefshme (Në rast të dorezimit të ofertes nga bashkimi i operatoreve ekonomike , cdo anetar i grupit duhet të paraqese certifikaten ISO sipas zerave të shërbimeve që do të marre persiper të realizoje sipas akt marreshjes).
- **ISO 14001:2015** (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) E vlefshme. (Në rast të dorezimit të ofertes nga bashkimi i operatoreve ekonomike , cdo anetar i grupit duhet të paraqese certifikaten ISO sipas zerave të shërbimeve që do të marre persiper të realizoje sipas akt marreshjes).



**Shënim:** Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të shërbimeve që do të realizojë.

**Argumentimi:** Kërkesat e mesipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e zbatimit që do të mbikëqyret dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

**ISO 9001:2015** -është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 14001:2015-** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike/termave të referencës

- Termat e Referencës për procedurën respektive janë hartuar nga Drejtoria e Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit të Bashkisë Krujë sipas të dhenave të shkresës me **nr.8036 Prot datë 16.11.2022** .Në hartimin e tyre janë marrë në konsiderat kërkesat ligjore të

fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit , konkretisht Ligjit nr.107/2014 ‘‘Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit’’, normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 ‘‘Për produktet e ndërtimit’’ i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores ‘‘Për sigurinë në kantier’’ si dhe kerkesat e Ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 ‘‘Për Kontrollin dhe V.K.M nr.354 date 11.05.2016’’ Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim’’ i ndryshuar.

- Termat e References per sherbimin e mbikqyrjes , jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.
- **Fondi Limit i perllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te V.K.M nr.354 date 11.05.2016** ‘‘Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim’’, dhe jane marre ne konsiderate te tere elementet perberes te sherbimeve te domosdoshme per ekzekutimin e kontrates dhe termave te references te hartuara nga grupi i punes i ngritur me urdher te Titullarit te AK.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ‘‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’’, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët ‘‘ose ekuivalenti i tij/saj’’.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët ‘‘ose ekuivalente’’.*